

GJYKATË E HAPUR

Buletin informativ i
Gjykatës Themelore të Prizrenit
Tetor – Dhjetor 2014

Buletin informativ “Gjykatë e Hapur”
Nr. 2, Janar 2015
Botues: Gjykata Themelore e Prizrenit
www.kgjk-ks.org

PËRMBAJTJE:

FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

2014, vit i përkushtimit dhe transparencës

STORIE E SUKSESIT

Strategjia që po i redukton lëndët e vjetra

LAJME

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

GJYKATA NË MEDIA

Kumtesat për media të Zyrës për Informim

INTERVISTË E SHKURTË

Riorganizimi i gjykatave forcon besimin e qytetarëve (Valon Totaj)

SI T'I QASEMI GJYKATËS?

Cila është detyra e ZQML-së?

A e dini se...?!

KONTAKTONI GJYKATËN THEMELORE TË PRIZRENIT



2014, vit i përkushtimit dhe transparencës

Të nderuar lexues,

Viti 2014 ishte vit i rezultateve konkrete të punës dhe e hapjes së mëtejme të Gjykatës Themelore të Prizrenit ndaj qytetarëve. Jam i lumtur që bëj pjesë në mesin e një ekipi të përkushtuar profesionistësh, të cilët janë dëshmia më e mirë e vullnetit të përkthyer në shërbime më të mira për qytetarët. Gjatë vitit 2014, Gjykata jonë i tejkaloi të gjitha parashikimet e punës, si në aspektin e trajtimit të lëndëve, po ashtu edhe në promovimin e standardeve të transparencës dhe llogaridhënies. Një pjesë e rëndësishme e suksesit të vitit 2014 i takon edhe bashkëpunëtorëve të shumtë të Gjykatës, të cilët ishin dhe vazhdojnë të jenë vlerë e shtuar e angazhimit për një *gjykatë të hapur*.

Para disa muajsh, hapëm një dritare të re të transparencës, duke e publikuar numrin e parë të buletinit informativ. Jemi tejet të motivuar që këtë mjet të transparencës po vazhdojmë ta mbajmë gjallë dhe para jush po e sjellim edhe numrin e dytë të buletinit. Ky publikim periodik ka për synim të ofrojë informacion mbi punën e gjykatës, statistikat e trajtimit të lëndëve, aktivitetet dhe projektet, qasjen e qytetarëve në gjykatë, përfshirjen mediale, dhe të tjera në shërbim të transparencës dhe llogaridhënies karshi qytetarëve.

Gjykata Themelore e Prizreni është gjykatë e hapur, e cila përrpiqet t'i përfshijë në punën e saj të gjithë qytetarët e Prizrenit. Ne tanimë kemi krijuar një traditë të mirë të bashkëpunimit me shumë partnerë, e ndër ta edhe me shkollat e qytetit. Një nga shembujt e shumtë është edhe marrëveshja e bashkëpunimit me shkollën e mesme Ymer Prizreni, drejtimi i juridikut, përmes së cilës, nxënësit e kësaj shkolle nga katër orë në javë janë pjesë vëzhguese e seancave gjyqësore. Synimi ynë është që gjatë vitit 2015 të shumëfishojmë numrin e partneriteteve, gjithnjë në shërbim të hapjes së Gjykatës.

Ymer Hoxha

Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren

Strategjia që po i redukton lëndët e vjetra

Një nga prioritetet e Gjykatës Themelore të Prizrenit në vitin 2014 ishte reduktimi i numrit të lëndëve të vjetra. Treguesit vjetorë të punës së Gjykatës dëshmojnë për sukses të konsiderueshëm të kësaj qasje strategjike. Sa i përket këtyre lëndëve, në të gjitha departamentet në këtë gjykatë janë trajtuar (përmbyllur) 2885 lëndë dhe kanë mbetur pa u përmbyllur edhe 1129 lëndë. Lëndët e papërfunduara kanë mbetur në trajtim për arsye objektive, qoftë si pasojë e mungesës së adresave, apo moszbatimit të urdhërësive nga ana e policisë. Një numër i lëndëve që duhet të përfundohet përmes kanaleve diplomatike ka paraqitur vështirësi në punën e Gjykatës. Por, me rëndësi për t'u potencuar është se asnjë lëndë të vjetër nuk ka mbetur pa i'u caktuar gjyqtari së paku dy herë. Tani si lëndë të strategjisë janë futur edhe lëndët e vitit 2012. Gjykata do të shtojë angazhimin e vet që plani i veprimit për reduktimin e lëndëve të vjetra i miratuar në shtator të vitit 2014 të realizohet në tërësi dhe me sukses.

LAJME

Vazhdon bashkëpunimi i Gjykatës me EC Ma Ndryshe

Gjykata Themelore e Prizrenit ka vazhduar bashkëpunimin me OJQ EC Ma Ndryshe me qëllim përmbushjen e aktiviteteve që dalin nga Strategjia e Komunikimit e Gjykatës Themelore, e hartuar gjatë vitit 2014. Strategjia e komunikimit është një nismë e re dhe përpjekje për të përmirësuar cilësinë e punës së kësaj gjykate, për të inkurajuar pjesëmarrjen dhe informimin e qytetarëve, si dhe rritjen e përgjegjshmërisë së shërbyesve të drejtësisë ndaj qytetarëve. Gjatë vitit të dytë të bashkëpunimit mes Gjykatës dhe EC Ma Ndryshe do të punohet në qëndrueshmërinë e mjeteve të komunikimit të prodhuara gjatë vitit 2014. Për më shumë, një program i ri për praktikantë do të fillojë së zbatuari gjatë muajve në vijim.

Studentët e juridikut vizitojnë Gjykatën

Një grup i studentëve të Juridikut të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren ishin pjesë e programit "Vizitë në Gjykatë – Njihu me stafin e gjykatës". Programi kishte për qëllim të nxisë komunikim më të besueshëm mes studentëve dhe Gjykatës Themelore në Prizren dhe t'u mundësojë atyre të njihen për së afërmi me gjykatën dhe me punën e gjyqtarëve brenda departamenteve të ndryshme.

Në pjesën e parë të vizitës studentët u akomoduan në njërën nga sallat e gjykimit dhe u pritën nga kryetari i Gjykatës Ymer Hoxha, zyrtarj për informim publik Afërdita Kicaj dhe gjykatësi Refki Piraj. Prezantimet fillestare u pasuan me diskutim mes studentëve dhe zyrtarëve të Gjykatës. Ndër të tjera u diskutua për të rejtat që ka sjellur reformimi i sistemit gjyqësor, mundësitë për takime direkte me kryetarin e Gjykatës dhe pjesëmarrjes në seanca gjyqësore të hapura për publikun, si dhe mundësitë e punës praktike për studentët e juridikut. Në pjesën e dytë të vizitës, studentët vizituan objektin e Gjykatës dhe u njohën me shërbimet që i ofron ajo për qytetarët e Prizrenit, me sallat e sencave gjyqësore, zyrën për menaxhimin e lëndëve dhe panë se ku dhe si operojnë departamentet brenda gjykatës.



Tridhjetë praktikantë të ri në Gjykatën Themelore



Kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit, Ymer Hoxha, me 26 nëntor 2014 ka pritur në takim praktikantët e ri të kësaj Gjykate, të cilët filluan praktikën një vjeçare në këtë institucion. Kryetari i Gjykatës ka potencuar para praktikantëve se kjo është hera e parë që kanë pranuar një numër kaq të madhe të praktikantëve. Praktikantët do të angazhohen nëpër divizione të ndryshme në Gjykatë, e që do të ju ndihmojë të njihen me punën e Gjykatës dhe të marrin përvoja të reja gjatë periudhës një vjeçare të praktikës. Gjithashtu, praktikantët do të marrin pjesë në seanca gjyqësore që mbahen në Gjykatë dhe do të njihen drejtpërdrejt me mënyrën e marrjes së vendimeve dhe zgjidhjen e rasteve të ndryshme gjyqësore.

Edhe nxënësit ndjekin seancat gjyqësore



Nxënësit e drejtimit juridik të ShML Ekonomike "Ymer Prizreni" në Prizren kanë filluar një program të praktikës në Gjykatën Themelore të Prizrenit, në kuadër të dy lëndëve mësimore. Kjo shkollë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Gjykatën, në mënyrë që nxënësit e drejtimit juridik të kryejnë punën praktike dhe të përcjellin seancat gjyqësore në sallat e gjykimeve. Programi i praktikës realizohet në kuadër të lëndëve "E drejta penale dhe procedurale" me udhëheqjen e profesorit Sedat Hamza dhe në lëndën "E drejta familjare dhe trashëgimore", me udhëheqjen e profesorëve Ardian Morina dhe Muhamet Shala. Nxënësit përcjellin programin e praktikës ditën e hënë, të mërkurë dhe të premte, saktësisht katër orë në javë punë praktike në gjykatë.

Gjykata në takim pune me Qendrën për Integrim dhe Zhvillim në Dragash

Përfaqësuesit e Qendrës për Integrim dhe Zhvillim në Dragash kanë takuar Zyrtaren për Informim të Gjytakës Themelore të Prizrenit, Afërdita Kicaj. Në takim është biseduar rreth lëndëve që janë shtjelluar në Gjykatë e që kanë të bëjnë me të drejtat e votimit ku palë në procedurë janë banorët e Komunës së Dragashit. Në kuadër të projektit “Për një Gjykatë Transparente dhe të Përgjegjshme”, kjo organizatë ka kërkuar të bëjë monitorimin e lëndëve për veprat penale kundër të drejtës së votimit dhe proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me shantazhin dhe ryshfetin e që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë janë të ndërlidhura me zgjedhjet. Gjykata Themelore në Prizren do të bashkëpunojë me Qendrën për Integrim dhe Zhvillim në këto çështje dhe njëherit ka shprehur gatishmërinë për t'i ofruar të gjitha lehtësirat në monitorim të lëndëve të lartcekura, nga data 24 tetor 2014 deri më 24 maj 2015.



GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

Tabela më poshtë paraqet statistikat e lëndëve të Gjykatës Themelore të Prizrenit për tërë vitin 2014, si ato të trashëguara në fillim të 2014, të ardhura, lëndët në proces, lëndët që janë përfunduar në këtë vit dhe ato të mbetura. Statistikat e punës për vitin 2014 janë dëshmia e rradhës numerike e përkushtimit maksimal të Gjykatës për t'i shërbyer qytetarëve.

Gjykata Themelore në Prizren	Lëndët e trashëguara në fillim të 2014	Lëndët e ardhura gjatë vitit 2014	Gjithsej lëndët në punë gjatë vitit 2014	Lëndët e kryera gjatë vitit 2014	Lëndët e mbetura në fund të vitit 2014
Departamenti për Krime të Rënda	424	545	969	546	423
Departamenti i Përgjithshëm	21376	20643	42109	22562	19457
Departamenti për të mitur	310	248	558	316	242
Divizioni i Kundërvajtjes	9846	29661	39507	34667	4840
Totali	31956	51097	83053	58091	24962


Kumtesat për media të Zyrës për Informim

Gjatë vitit 2014, Zyra për Informim e Gjykatës Themelore të Prizrenit ka lëshuar rreth 90 kumtesa për media, të cilat kanë pas për qëllim të njoftojnë publikun mbi rastet e paraburgimeve dhe të shqiptimit të dënimeve për seancat që janë të hapura për publikun. Kumtesat për media të gjykatës janë paraqitur në të gjitha televizionet lokale në pothuaj të gjitha rastet. Me qëllim njoftimit e publikut për seancat gjyqësore që mbahen në gjykatë, Zyra për Informim ka vazhduar të njoftojë mediat në baza të përditshme me tabelën e seancave gjyqësore, të cilat kanë njoftuar rreth orës, sallës së gjyqimit, numrit të lëndës dhe gjyqtarit të lëndës. Televizioni i Prizrenit, TV Opinioni, TV Besa, Prizren Press, Radio Kosova, Gazeta Zëri dhe Kallxo.com, kanë qenë mediat të cilat kanë përfshirë më së shumti kumtesat dhe ngjarjet e kësaj gjykate.



INTERVISTË E SHKURTË

Riorganizimi i gjykatave forcon besimin e qytetarëve



VALON TOTAJ

Procesi i reformës përmes riorganizimit të gjykatave, përkatësisht të Gjykatës Themelore të Prizrenit, po ndikon në avancimin e punës profesionale dhe të përgjegjshme, parakushte këto të forcimit të besimit qytetar ndaj

Gjykatës. Për të konsoliduar edhe më tej këtë besim, angazhohet edhe Valon Totaj, Udhëheqës i Divizionit Civil të Gjykatës Themelore të Prizrenit, të cilin e ftuam për intervistën e shkurtë të këtij numri.

1. Sa efikase është Gjykata Themelore në punën e saj?

Konsideroj se Gjykata Themelore e Prizrenit është mjaft efikase në kryerjen e punëve të saja. Bazuar në statistikat të cilat janë përpiluar nga zyrtari i statistikave të kësaj gjykate, del se në vitin 2014, realizimi i normës së punës për gjyqtar ka qenë 118 %, çka do të thotë se të gjithë gjyqtarët e kësaj gjykate e kanë tejkaluar normën e caktuar nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ky efikasitet nuk ka të bëjë vetëm me shifrën e përqindjes, por edhe me faktin se aktualisht në Gjykatën Themelore ka rënë dhe është në rënie e sipër numri i lëndëve të cilat janë në punë, ku si rezultat i kësaj, tani palët presin shumë më pak për caktimin e lëndëve të tyre, se sa në vitin 2012 apo në vitin 2011.

2. Sa jeni të sfiduar nga numri i madh i lëndëve në punën tuaj të përditshme?

Sigurisht se njëra prej sfidave më të mëdha në punën e gjyqtarit është numri i madh i lëndëve. Me një sfidë të tillë jemi ballafaquar sidomos në fillimin e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në vitin 2010. Për shkak se asokohe numri i gjyqtarëve ishte shumë i vogël, por edhe duke e pasur parasysh procesin e reformimit të përgjithshëm nëpër të cilin ishte duke kaluar sistemi gjyqësor i Kosovës, ka ndodhur që qytetarët e Kosovës, të detyrohen të presin gjatë në kryerjen e lëndëve të tyre. Mirëpo me kalimin e kohës dhe me jetësimin e reformave të gjithanshme në sistemin gjyqësor të Kosovës, situata ka ardhur duke u përmirësuar dukshëm. Aktualisht, numri i lëndëve në punë pranë kësaj gjykate është nën kontroll, pra përkthyer në gjuhën e kuptueshme për të gjithë, kjo do të thotë se qytetarët e Prizrenit dhe jo vetëm ata, nuk detyrohen më që të presin me vite apo edhe dekada të tëra që gjykata t'i caktoj në punë lëndët e tyre.

3. Hulumtimet tregojne për nivel jo te madh të besimit qytetar ndaj Gjykatës. Pse ndodh kjo? Si reagoni si gjyqtar kur dëgjoni raporte të tilla?

Çështja e besimit apo mosbesimit të qytetarëve ndaj gjykatës apo edhe institucioneve të tjera shtetërore është një çështje komplekse. Shumë faktor në të kaluarën kanë ndikuar që institucionet shtetërore asnjëherë të mos shikohen me sy të mirë, përkatësisht si organe ku ata do t'i zgjidhnin kontestet e tyre dhe t'i realizonin të drejtat e tyre qytetare. Prandaj, personalisht nuk befashohem shumë kur dëgjojë për hulumtime të tilla të cilat dëshmojnë për mosbesimin e qytetarëve ndaj gjykatave, sepse ky mosbesim pjesërisht është i kuptueshëm. Sidoqoftë, gjërat tani kanë filluar të ndryshohen për mirë dhe shpresoj se shumë shpejt edhe besimi i qytetarëve do të fillon të krijohet dhe forcohet ndaj institucioneve shtetërore në përgjithësi, por edhe ndaj gjykatave në veçanti. Do të mundohemi që me punën tonë t'ua bëjmë me dije të gjithë qytetarëve tanë se ne jemi aty për ata, e jo ata për neve.

4. Çfarë duhet bërë që të forcohet besimi qytetar ndaj Gjykatës?

Mendoj se ajo çfarë duhet të bëjmë të gjithë ne si gjyqtar, është që të gjithë t'i kryejmë punët tona me nder dhe profesionalizëm. Vetëm në këtë mënyrë do të arrijmë që tek

qytetarët tonë ta krijojmë dhe forcojmë besimin ndaj gjykatës. Konsideroj se pas reformës së bërë në kuptim të riorganizimit të gjykatave, përkatësisht të Gjykatës Themelore në Prizren, janë krijuar kushtet që përmes punës profesionale dhe të ndërgjeshme të fitohet dhe forcohet besimi i qytetarëve ndaj gjykatës. Jam i mendimit se në gjykatën tonë, koha e numrave në kuptim të lëndëve të përfunduara, ka kaluar. Tani duhet të jetë koha e cilësisë së lëndëve të përfunduara.

5. Sa bashkëpunoni me organizatat e shoqërisë civile në Prizren?

Gjykata Themelore e Prizrenit është e hapur për bashkëpunim me të gjitha organizatat e shoqërisë civile në Prizren. Bashkëpunim të veçantë kjo gjykatë ka me organizatën EC Ma Ndryshe, me të cilën edhe janë realizuar një mori aktiviteteve si debate e vizita në gjykatë me qytetarë e studentë, janë prodhuar disa materiale të rëndësishme për qytetarët, përmes të cilave është mëtuar që të rritet komunikimi në mes të qytetarëve të Prizrenit si dhe kësaj gjykate. Gjykata do të jetë e hapur për bashkëpunim me të gjitha organizatat e shoqërisë civile të cilat janë të interesuara që ta avansojnë komunikimin në mes të qytetarëve të Prizrenit dhe gjykatës së tyre.

SI T'I QASEMI GJYKATËS?

Cila është detyra e ZQML-së?

Detyra kryesore e Gjykatës është që të procedojë me lëndët në kohë dhe në mënyrë transparente. Zyra Qendrore për Menaxhimin e Lëndëve (ZQML) ndihmon në përmbushjen e kësaj objektivë përmes shkurtimeve të vonesave në procedimin e lëndëve, racionalizimit të punës së personelit të Gjykatës, qartësisht të ndarjes së përgjegjësisë ndërmjet gjykatësve dhe stafit përkrahës, si dhe krijimit të mekanizmave të llogaridhënies për procedimin e lëndëve dhe përputhjen me afatet procedurale. ZQML-ja është përgjegjëse për lëvizjen e lëndëve brenda Gjykatës prej pranimit deri në marrje të vendimit. Përmes veprimeve tekniko-administrative, stafi i ZQML-së iu mundëson gjykatësve që të fokusohen në gjykimin brenda kohës së arsyeshme. Stafi i ZQML-së kujdeset që faktorët brenda dhe jashtë kontrollit të Gjykatës të mos ndikojnë në krijimin e vonesave në procedimin e lëndëve.

A e dini se...?!

1. Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor. (LIGJI Nr. 03/L-199 PËR GJYKATAT, Neni 7, paragrafi 2)
2. Zyra për informim publik është një veçori e re e cila u paraqit si nevojë e përmirësimit dhe intensifikimit të komunikimit me publikun nga ana e gjykatës.

Rregullë: Roli i koordinatorit për Informim të Publikut është i dyfishtë. Së pari, ai merret me të gjitha kërkesat e publikut për informata dhe i paraqet ato personelit relevant të gjykatës. Së dyti, ai kujdeset për të gjitha informatat e gjykatës të cilat kanë natyrë publike dhe i bën të disponueshme për publikun.



KONTAKTONI GJYKATËN THEMELORE TË PRIZRENIT

ZYRA E ADMINISTRATËS:

Tel: +381 (0) 29 / 244 122

ADRESA:

Gjykata Themelore e Prizrenit
Rr. "Ibrahim Lutfiu ", p.n.
Prizren, Kosovë

VIZITO:

www.kgjk-ks.org



GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

OSNOVNI SUD U PRIZRENU –PRIZREN TEMEL MAHKEMESI
BASIC COURT OF PRIZREN



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

Ky publikim është rezultat i bashkëpunimit mes Gjykatës Themelore të Prizrenit dhe EC Ma Ndryshe, në kuadër të iniciativës "Gjykatë e Hapur".